



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 139, Datë 02.04.2021

PËR
MIRATIMIN E “KOMENTE DHE SUGJERIME MBI REZULTATET E VLERËSIMIT
PARAPRAK NGA SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TË KANDIDATEVE
QË KANË APLIKUAR PËR PRANIMIN NË FORMIMIN FILLESTAR PËR
MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar ne Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, profile gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021”, sipas tekstit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

KOMENTE DHE SUGJERIME MBI REZULTATET E VLERËSIMIT PARAPRAK NGA SHKOLLA E MAGJISTRATURËS TË KANDIDATEVE QË KANË APLIKUAR PËR PRANIMIN NË FORMIMIN FILLESTAR PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 35, datë 28.01.2021, ka përcaktuar, ndër të tjera, edhe numrin e kandidatëve magistratë/profili gjyqtar që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022.

Pas këtij vendimi, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës (në vijim SHM), në datë 01.02.2021, ka vendosur të publikojë thirrjen për kandidime për pranimin në formimin fillestar për magistrat. Po ashtu, Këshilli Drejtues i SHM ka miratuar edhe përbërjen e Komisionit të Administrimit të Provimit, si dhe ka caktuar datën e zhvillimit të provimit të pranimit, pikërisht në datat 19 dhe 22 prill 2021. Në vendim është përcaktuar gjithashtu edhe periudha e regjistrimit për kandidatët në formimin fillestar, në përputhje me nenin 30 të Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim Ligji “Për Statusin”).

Me anë të njoftimit publik janë informuar të gjithë të interesuarit për fillimin e procedurës së aplikimeve, periudhën gjatë të cilës SHM do të pranonte dhe mblidhte dokumentacionin e personave të interesuar, datat e zhvillimit të provimit të pranimit, kriteret që duhet të plotësoheshin sipas rastit, të parashikuara në nenin 28 të Ligjit “Për Statusin”, si dhe në nenin 10 të Rregullores së Brendshme të SHM, si dhe për dokumentet që duhet të dorëzohen nga personat e interesuar, parashikuar në nenin 11 të Rregullores.

Për gjatë periudhës 1 deri në 28 shkurt 2021, Sekretaria Shkencore për Formimin Fillestar pranë SHM ka pranuar aplikimet nga personat e interesuar për të marrë pjesë në provimin e pranimit. Gjatë periudhës së regjistrimit, personat që kanë shprehur interesin dhe kryer procedurat e regjistrimit për të marrë pjesë në konkurs janë në total 286 (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë), nga të cilët:

- 286 (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) aplikues vetëm për kandidatë për magistratë (profili gjyqtar dhe prokuror).
- 282 (dyqind e tetëdhjetë e dy) aplikues vetëm për kandidatë për magistratë (profili gjyqtar).
- 4 (katër) kandidatë kanë aplikuar vetëm për magistratë (profili prokuror).

Pas përfundimit të periudhës së regjistrimit, Komisioni për verifikimin e dokumentacionit i ngritur në SHM, ka filluar punën për të verifikuar përmbushjen e kriterëve të konkurrentëve si edhe dokumentacionin e kërkuar nga ana e Shkollës, për të dëshmuar plotësimin e këtyre kriterëve.

Më 12 mars 2021, mbi bazën e verifikimeve të kryera, Komisioni ka evidentuar gjetjet për çdo aplikim të paraqitur dhe ka arritur në përfundimin se:

- 282 (dyqind e tetëdhjetë e dy) kanë aplikuar për të konkurruar për magistrat,
- 250 (dyqind e pesëdhjetë) prej aplikantëve të interesuar përmbushin kriteret ligjore për kandidatë për magistratë;
- 32 (tridhjetë e dy) prej aplikantëve të interesuar nuk përmbushin kriteret ligjore për kandidatë për magistratë.

Në vijim, raporti për rezultatet e vlerësimit paraprak, si dhe dokumentacioni i kandidatëve, i janë përcjellë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në respektim të pikës 4, të nenit 30, të Ligjit “Për Statusin”, sipas të cilit:

1. *Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti.*
2. *Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit.*
3. *Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji.*
4. ***Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij.***
5. *Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe aktet nënligjore përkatëse.*

Sipas dispozitës së mësipërme, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të japë komente ose kundërshtime, në lidhje me rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve nga SHM, duke qenë kjo e fundit organi përgjegjës kompetent për të vendosur përfundimisht për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, pra për kualifikimin ose përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në provimin e pranimit për në formimin fillestar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin që komentet dhe sugjerimet e tij t’i bazojë në ligj, pikërisht referuar kriterëve të përcaktuara në nenin 28 të Ligjit “Për Statusin”, sipas të cilit:

1. *Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme:*
 - a) *ka zotësi të plotë për të vepruar;*
 - b) *është shtetas shqiptar;*
 - c) *ka përfunduar, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë “Master i shkencave”, si dhe ka dhënë provimin e shtetit për jurist në Shqipëri, ose ka kryer, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, studimet universitare për drejtësi në një vend anëtar të Bashkimit Evropian dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuara me ligj;*
 - ç) *ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare;*
 - d) *nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë;*
 - dh) *nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;*
 - e) *nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit;*
 - ë) *nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;*
 - f) *nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.*

Kriteret e mësipërme ligjore janë detajuar më tej në Rregulloren e Brendshme të SHM, ku në nenin 10 të saj përcaktohet se:

1. *Shkolla e Magjistraturës, brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e përcaktimit dhe e publikimit të numrit maksimal të kandidatëve për magistratë, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për kandidatët për gjyqtarë dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për kandidatët për prokurorë, por jo më vonë se data 1 shkurt, shpall njoftimin për paraqitjen e kërkesave të aplikantëve për të konkurruar në provimin e pranimit, duke bërë të njohur datën e provimit, dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesat, datën e mbarimit të afatit për paraqitjen e tyre, si dhe programin e provimit të pranimit.*
2. *Shpallja e njoftimit bëhet:*
 - a) *në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Shkollës së Magjistraturës;*
 - b) *në të paktën një prej gazetave me tirazh më të lartë në vend.*
3. *Regjistrimi bëhet në përputhje me ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe me kushtet e përcaktuara në nenet 29, 30 të ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin” e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*
4. *Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në Formimin Fillestar për magistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme:*
 - a) *ka zotësi të plotë për të vepruar;*
 - b) *është shtetas shqiptar;*
 - c) *ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë “Master i shkencave”, ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë, referuar nenit 124 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë”. Diplomimi i tyre duhet të mbështetet në përfundimin e një programi sipas sistemit të Bolonjës 5-vjeçar, ose të jetë diplomuar si “Jurist” me një diplomë universitare të fituar para përshtatjes së studimeve sipas sistemit të Bolonjës në një program 4- vjeçar, e cila është ekuivalente me një Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë, (DIND)”;*
 - d) *ka notë mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë), si dhe notë mesatare mbi 8 (tetë) për grupin e lëndëve kryesore, ku përfshihen: E drejta civile dhe e detyrimeve, E drejta penale, (Pjesa e përgjithshme dhe pjesa e posaçme), Procedura civile, Procedura penale, E drejta administrative dhe e drejta kushtetuese. Për të diplomuarit “Juristë”, në programe në gjuhë të huaj, parashikohet një koeficient vështirësie i barabartë me 1.2, i cili do të ponderojë mesataren e tyre faktike;*
 - e) *ka dhënë provimin e shtetit për jurist në Shqipëri, ose ka kryer, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, studimet universitare për drejtësi në një vend anëtar të Bashkimit Evropian dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj;*
 - f) *ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, pas diplomimit në ciklin e plotë të studimeve universitare, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare;*
 - g) *nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë;*
 - h) *nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;*
 - i) *nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit;*
 - j) *nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;*
 - k) *nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete.*
5. *Nuk lejohen të konkurrojnë në Shkollën e Magjistraturës stafi i brendshëm i saj, si dhe familjarë apo persona të lidhur me ta, për një periudhë deri në një vit nga koha e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së tyre me Shkollën e Magjistraturës.*

6. *Kandidatët për pozicionet në Avokaturën e Shtetit i nënshtrohen të njëjtave rregulla për regjistrim dhe për konkurrim si kandidatët për magjistratë.*

Referuar kritereve të pranimit në formimin fillestar, Këshilli konsideron bërjen e komenteve dhe sugjerimeve në lidhje me rezultatet e vlerësimit paraprak nga SHM për aplikantët që kanë kandiduar për magjistrat, profili gjyqtar, me qëllim që ato të vlerësohen nga SHM, në kuadër të miratimit të raportit të vlerësimit përfundimtar.

I. Komente dhe sugjerime për aplikantët që janë vlerësuar paraprakisht se përmbushin kriteret ligjore:

1) Për aplikanten **znj. Antigona Qamil Toshi**, sa i përket përmbushjes së kriterit të përvojës së nevojshme profesionale, pas përfundimit të plotë të studimeve universitare, sipas nenit 10 pika 1, shkronja “f”, të Rregullores së Shkollës, sugjerohet rivlerësimi i kohëzgjatjes së përvojës profesionale për këtë aplikante pasi, sipas përllogaritjes në bazë të dokumenteve të depozituar nga aplikantja, kjo e fundit nuk duket që të ketë tre vjet përvojë profesionale me kohë të plotë sikurse kërkohet nga neni 28, pika 1, shkronja “ç”, e Ligjit “Për Statusin”.

Për këtë mbahet parasysh se, sipas dokumentit Librezë Pune, për aplikanten jepen këto të dhëna punësimi: periudha 05.04.2017 - 01.09.2017, “Asistente avokate” pranë Avokates Lirime Çukaj; periudha 14.11.2018 - 22.11.2019, “Avokate” pranë “Pharma One”; periudha 25.11.2019 - 30.04.2020, “Specialiste/Juriste” Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; periudha 24.09.2020 e në vijim, “Juriste” pranë East-West Menagement Institute. Në total, periudha e punësimit e aplikantes, deri në momentin e aplikimit, është pak më shumë se 2 vjet e 2 muaj, pra më e vogël se 3 vjet.

2) Për aplikanten **znj. Jona Agim Biba**, sa i përket përmbushjes së kriterit të përvojës së nevojshme profesionale, pas përfundimit të plotë të studimeve universitare, sipas nenit 10 pika 1, shkronja “f”, të Rregullores së Shkollës, sugjerohet rivlerësimi i kohëzgjatjes së përvojës profesionale për këtë aplikante pasi, sipas përllogaritjes në bazë të dokumenteve të depozituar nga aplikantja, kjo e fundit nuk duket që të ketë 3 vjet përvojë profesionale me kohë të plotë, sikurse kërkohet nga neni 28, pika 1, shkronja “ç”, e Ligjit “Për Statusin”.

Duket që në përllogaritjen e përvojës profesionale për aplikanten, sipas rezultateve të vlerësimit paraprak, të jetë përfshirë edhe periudha 19.09.2015 - 04.05.2018, referuar prej saj si “asistent notere”, pranë noterës publike Anila Gjermani. Në fakt, sipas shënimit të bërë në Librezën e Punës, aplikantja ka mbajtur pozicionin “Sekretare”. Nga aplikantja nuk është paraqitur dokument provues sa i përket regjistrimit si “asistent notere” sikurse deklarohet nga Shkresa e datës 31.05.2018, lëshuar nga noterja Anila Gjermani. Sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9829, datë 01.06.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar (ligji në fuqi në kohën e krijimit të kësaj marrëdhënie), në nenin 3/c të tij, parashikohej se: *“Noteri, në ushtrimin e veprimtarisë së vet noteriale, mund të asistohet nga një ose më shumë asistentë. Brenda 15 ditëve nga lidhja e kontratës me asistentin, noteri duhet të depozitojë në dhomën e noterisë ku është anëtar, në Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe në Ministrinë e Drejtësisë kopje të kontratës dhe dokumentacionin ligjor të kërkuar për asistentët. Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së tij, asistenti duhet të regjistrohet në regjistrin përkatës të Ministrisë së Drejtësisë dhe të depozitojë dokumentacionin e kërkuar prej saj.”* Në rastin konkret, nga dokumentacioni i administruar, nuk rezulton që midis znj. Biba dhe Noteres Anila Gjermani të jetë lidhur një

kontratë e kësaj natyre dhe as të jenë përmbushur detyrimet për deklarimin dhe regjistrimin e saj pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.

3) Për aplikanten **znj. Besjana Qamil Hoxhaj**, sa i përket përmbushjes së kriterit të përvojës së nevojshme profesionale, pas përfundimit të plotë të studimeve universitare, sipas nenit 10 pika 1, shkronja “f”, të Rregullores së Shkollës, sugjerohet rivlerësimi i kohëzgjatjes së përvojës profesionale për këtë aplikante pasi, sipas përlllogaritjes në bazë të dokumenteve të depozituar nga aplikantja, kjo e fundit nuk duket që të ketë tre vjet përvojë profesionale me kohë të plotë sikurse kërkohet nga neni 28, pika 1, shkronja “ç”, e Ligjit “Për Statusin”.

Duket që në përlllogaritjen e përvojës profesionale për aplikanten, sipas rezultateve të vlerësimit paraprak, të jenë përfshirë periudha 01.01.2013 - 31.12.2015, referur prej saj si “asistent notere”, pranë noterës publike Rudina Hoxhaj, si dhe periudha 15.06.2017 -30.04.2019, referur prej saj si “asistent notere”, pranë noterës publike Çetina Hoxhaj. Në fakt, sipas shënimeve të bëra në Librezën e Punës, aplikantja ka mbajtur pozicionin “Sekretare”. Nga aplikantja nuk është paraqitur dokument provues sa i përket regjistrimit si “asistent notere” sikurse kërkohet nga ligji i kohës, Ligji nr. 9829, datë 01.06.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar.

4) Për aplikanten **znj. Sonila Vullnet Qerolla**, sa i përket përmbushjes së kriterit të përvojës së nevojshme profesionale, pas përfundimit të plotë të studimeve universitare, sipas nenit 10 pika 1, shkronja “f”, të Rregullores së Shkollës, sugjerohet rivlerësimi i kohëzgjatjes së përvojës profesionale për këtë aplikante pasi, sipas përlllogaritjes në bazë të dokumenteve të depozituar nga aplikantja, kjo e fundit nuk duket që të ketë tre vjet përvojë profesionale me kohë të plotë sikurse kërkohet nga neni 28, pika 1, shkronja “ç”, e Ligjit “Për Statusin”.

Duket që në përlllogaritjen e përvojës profesionale për aplikanten, sipas rezultateve të vlerësimit paraprak, të jenë përfshirë periudha 03.10.2016 - 31.10.2017, gjatë të cilës, sipas Vërtetimit datë 15.02.2021, lëshuar nga Avokati Isa Shameti, aplikantja ka kryer stazhin si “asistent avokate”, mirëpo nuk rezultojnë të jenë derdhur kontribute për këtë periudhë dhe sipas ligjit të kohës, periudha si “asistent avokat” nuk njihet si periudhë vjetërsie në punë, përveç kur provohet ndryshe. Kështu, referuar Ligjit nr. 9109, datë 17.07.2003, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji i kohës), në nenin 29 të tij, përcaktohet se: *“Avokati ka të drejtë të ketë një ose më shumë asistentë. Asistentët zgjidhen nga vetë avokati ndërmjet personave të diplomuar juristë, që nuk kanë marrë lejen për ushtrimin e profesionit të avokatit. Avokati ka për detyrë që, brenda 15 ditëve nga ajo e lidhjes së marrëdhënies të punës me asistentin, të depozitojë dokumentacionin e tij për regjistrim në dhomën e avokatisë ku është anëtar, në Dhomën Kombëtare të Avokatisë, si dhe në Ministrinë e Drejtësisë. Me autorizimin me shkrim të avokatit dhe, kurdoherë, me pëlqimin me shkrim të klientit, asistenti përfaqëson ose mbron të interesuarit në periudhën hetimore, në gjykimin e kundërvajtjeve penale dhe në seancat përgatitore për çështjet civil”*. Në rastin konkret, nga dokumentacioni i administruar, nuk rezultojnë që midis znj. Qerolla dhe Avokatit Isa Shameti të jetë lidhur një kontratë e kësaj natyre dhe as të jenë përmbushur detyrimet për deklarimin dhe regjistrimin e kandidatës pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe as të jenë ndjekur procedurat përkatëse që kërkon ligji.

5) Për aplikantin **z. Lixhers Xhevat Mali**, sa i përket përmbushjes së kriterit të përvojës së nevojshme profesionale, pas përfundimit të plotë të studimeve universitare, sipas nenit 10, pika 1, shkronja “f”, të Rregullores së Shkollës, sugjerohet rivlerësimi i kohëzgjatjes së përvojës

profesionale për këtë aplikant pasi, sipas përlllogaritjes në bazë të dokumenteve të depozituar nga aplikanti, ky i fundit nuk duket që të ketë tre vjet përvojë profesionale me kohë të plotë sikurse kërkohet nga neni 28, pika 1, shkronja “ç”, e Ligjit “Për Statusin”. Për këtë mbahet parasysh se, sipas dokumenteve Librezë Pune dhe Vërtetim “Mbi bazën e vlerësuar” datë 01.03.2021, për aplikantin konstatohet që të ketë filluar punë më datë 19.06.2018. Nisur nga ky fakt, deri në momentin e aplikimit, aplikanti ka gjithsej 2 vite, 8 muaj dhe 10 ditë përvojë profesionale, pra më pak se 3 vjet.

II. Komente dhe sugjerime për aplikantët që janë vlerësuar paraprakisht se nuk përmbushin kriteret ligjore:

1) Për aplikanten **znj. Luljeta Ndue Vocaj**, për të cilën është vlerësuar se nuk përmbush kriterin e mesatares së përgjithshme, parashikuar nga neni 10, pika 4, shkronja “d”, e Rregullores së Brendshme të SHM, duke u evidentuar se kjo mesatare është “7.97”, sugjerohet rivlerësimi i mesatares së llogaritur. Nga përlllogaritja e mesatares së përgjithshme për aplikanten, duket që ajo është në nivelin “8.34”. Pasaktësia në llogaritjen e mesatares së përgjithshme për aplikanten mund të ketë ardhur nga një gabim që konstatohet në Dokumentin “Vërtetim Notash” nr. 2775 prot., datë 14.10.2011, ku në lidhje me numrin e lëndëve të kategorisë *B-Disiplina të formimit karakterizuaes të programit I-të detyrueshme për të gjithë*, ka një kapërcim nga numri rendor “10” në numrin rendor “13”, ndërsa në fund rezultojnë lëndë totale “31”, ndërkohë që në realitet lëndët janë “29”.

2) Për aplikanten **znj. Gentiana Myfid Sherri**, për të cilën është vlerësuar se nuk përmbush kriterin e mesatares së lëndëve kryesore, parashikuar nga neni 10, pika 4, shkronja “d”, të Rregullores së Brendshme të SHM, duke u evidentuar se kjo mesatare është “7.88”, sugjerohet rivlerësimi i mesatares së llogaritur. Nga përlllogaritja e mesatares së lëndëve kryesore për aplikanten, duket që ajo është në nivelin “8.875”.

3) Për aplikanten **znj. Izabela Robert Kote**, për të cilën është vlerësuar se nuk përmbush kriterin e përvojës së nevojshme profesionale, pas përfundimit të plotë të studimeve universitare, duke përfshirë edhe “Masterin Shkencor”, sipas nenit 10 pika 1, shkronja “f”, të Rregullores së Brendshme të SHM, Shkollës, sugjerojmë që përvoja profesionale e aplikantes të rivlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 28, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit “Për Statusin”, i cili kërkon si kriter të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë. Për këtë, duke filluar nga mbarimi i Bachelor-it, sugjerojmë që periudha e punës së aplikantes të njihet si përvojë pune profesionale, mbi arsytimin se nuk mund të trajtohen në mënyrë të pabarabartë kandidatët që kryejnë të njëjtën punë pas përfundimit të Masterit Shkencor, me ata që e kanë kryer atë që pas mbarimit të Bachelor-it dhe Masterit Profesional, si në rastin konkret, në kushtet kur ligji nuk e ndalon punësimin. Gjithsesi, konsiderimi i këtij sugjerimi, nuk ndikon në përfundimin e arritur në vlerësimin paraprak, pasi aplikantja nuk përmbush edhe një nga kriteret e tjera.

4) Për aplikantët **znj. Klerona Isuf Meçi, znj. Romina Fatmir Pulaj, z. Ahmehd Shkëlqim Ramadani**, për të cilët është vlerësuar se nuk përmbushin kriterin e mesatares së përgjithshme, parashikuar nga neni 10, pika 4, shkronja “d”, e Rregullores së Brendshme të SHM. Sugjerohet rivlerësimi i mesatares së llogaritur, pasi nga përlllogaritjet e bëra duket që mesatarja e përgjithshme për këta kandidatë është e ndryshme nga ajo e evidentuar në rezultatet e vlerësimit paraprak. Ky rishikim i mesatares së përgjithshme të llogaritur vlen të konsiderohet edhe për disa kandidatë të tjerë të pa specifikuar më lart, për të cilët, pavarësisht se nuk përmbushin ndonjë

prej kritereve të tjera, duhet që rezultatet përfundimtare të pasqyrojnë me saktësi realitetin për çdo kriter.

5) Për aplikantin **z. Artil Ilirjan Mandro**, për të cilin është vlerësuar se është në kushtet e ndalimit të parashikuar në nenin 10, pika 5, të Rregullores së Brendshme të SHM, për shkak se: *“Nuk lejohen të konkurrojnë në Shkollën e Magjistraturës stafi i brendshëm i saj, si dhe familjarë apo persona të lidhur me ta, për një periudhë deri në një vit nga koha e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së tyre me Shkollën e Magjistraturës. Z. Mandro është person i lidhur me një pedagog të brendshëm, e për rrjedhojë nuk lejohet të marrë pjesë në provimin e pranimit, sipas parashikimit të nenit 10, pika 5 e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës”*. Sugjerohet rivlerësimi i këtij përfundimi me arsyetimin se ligji lejon konkurrimin në SHM të çdo personi që plotëson kriteret e përcaktuara prej tij, duke mos penguar kështu kandidimin për në formimin fillestar edhe të personave që janë familjarë apo të lidhur me stafin e brendshëm të SHM. Duket qartë se rregullimi në nenin 10, pika 5, të Rregullores së Brendshme të SHM, është bërë në funksion të parandalimit të “konfliktit të interesit”, por se ky rregull, pavarësisht parandalimit të “konfliktit të interesit”, në fakt iu mohon individëve të drejta kushtetuese dhe ligjore. Nga ana tjetër, referuar Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, është “zyrtari”, sikundër edhe çdo epror dhe institucion epror, ata që kanë për detyrë parandalimin dhe zgjidhjen e çdo gjendje konflikti interesi, në mënyrën më të frytshme të mundshme.

6) Për aplikantët **znj. Enxhi Edmond Konini, znj. Esmeralda Lirim Rama, z. Oltion Zef Vathaj, znj. Alma Agim Dushku, znj. Kejsi Agron Kosta dhe z. Kris Arben Hasa**, për të cilët është vlerësuar se nuk përmbushin kriterin e përvojës së nevojshme profesionale, pas përfundimit të plotë të studimeve universitare, duke përfshirë edhe “Masterin Shkencor”, sipas nenit 10, pika 1, shkronja “f”, të Rregullores së Brendshme të SHM, sugjerojmë që përvoja profesionale e këtyre aplikantëve të rivlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 28, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit “Për Statusin”. Sikurse dhe më lart u përmend, kjo dispozitë ligjore kërkon si kriter të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë. Ndaj, nëse punësimi i aplikantëve në fjalë ka qenë aktiv me kohë të plotë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare, duke filluar që pas mbarimit të Bachelor-it, sugjerohet që kjo periudhë të njihet si përvojë pune profesionale edhe nëse aplikanti e ka kryer më pas Masterin Shkencor. Në vlerësim të Këshillit, nuk duhet të ketë trajtim të pabarabartë mes kandidatëve që e kryejnë të njëjtën punë pas përfundimit të Masterit Shkencor, me ata që e kanë kryer atë që pas mbarimit të Bachelor-it, në kushtet kur ligji nuk e ndalon punësimin.

KOMISIONI I PËRKOHSHËM